

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shkodra ka plot dashuri" vjen në skenën e Teatrit Migjeni
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/shkodra-ka-plot-dashuri-vjen-ne-skenen-e-teatrit-migjeni-i588472
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:26:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e75bad8759e9485580ebef526ff9b556cff90b8dfe8d8e72c418c6efe7498423
TEKSTI	3003d0f0aab04f01e6ecfde83795f08b6c4d413bbff49286c320e608a8c98902
PAMJA	33b589b72bb9532fedb3d2df2f2260f9287dcbb2af34fedb1863d3cdb0e3e1e3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6d481bee4647e665896b702edec25dafa76707fabfed55909edd535d495bdb23
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6d481bee4647e665896b702edec25dafa76707fabfed55909edd535d495bdb23>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Sot ndeshja Shqiptari - Bjellorusi, policia publikon masat! Ja rruget qe do te bllokohen](#) [Çelet te Vila 31 ekspozita kushtuar grave te Ballkanit](#) [Bë i kerkon Mbretërisë se Bash](#)
fundit

“Shkodra ka plot dashuri” vjen në skenën e Teatrit Migjeni



26 Shtator 2026, 17:23 Kulturë TEMA



Humori rikthehet në skenën e Teatrit “Migjeni” dhe këtë herë vjen me “Shkodra ka plot dashuri”. Premiera u shoqërua me një sallë të mbushur plot artdashës dhe me duartrokitje që shoqëruan gjatë gjithë mbrëmjes interpretimet e aktorëve.

Nën regjinë e Zehrudin Dokles dhe drejtimin muzikor të Ilir Zogës, shfaqja risolli në skenë traditën e estradës shkodrane, duke ndërthurur emrat e njohur të humorit me artistët e rinj, që synojnë ta çojnë përpara këtë traditë.

“Gjithmonë Shkodra është frymëzim për artistë, pa diskutim. Bile ne në këtë çfarë që kishim planifikuar edhe mjeshterin e madh, Bes Çinarin, Agron Dizdarin, po ata për arsye shëndetësore. Por ne u munduam edhe me këta të rinjtë që janë me të vërtetë shpresë e madhe për t’i zëvendësuar, se ndryshe nuk kuptohet Shkodra. Shkodra është një vazhdimësi e tërë”, u shpreh Zehrudin Dokles.

Për protagonistët, ngjitja në skenën e “Migjenit” mbetet gjithmonë një moment i veçantë, por këtë herë emocionit i shtohet edhe rikthimi i humorit shkodran përballë publikut.

“Zehrudini kthehet pas kaq vitesh, sepse Zehrudini jeton në Sofje, por shpirtin e ka gjithmonë në Shkodër, edhe pse s’është shkodran. Kena pa një punë shumë të mirë, me një atmosferë të mrekullueshme. Kena punu me këta djem e vajza të reja, shumë të talentum. Ishte kënaqësi shumë e madhe; kena pas një atmosferë të mrekullueshme pune. Suksesi u pa; besoj se këto që ishin sonte do të hapin opinion të mirë, që spektatorë tjerë, megjithëse ka një interes shumë të madh, edhe me të vërtetë Shkodra ka shumë dashni”, është shprehur aktorja Drande Xhaj.

“Shkodra ka plot dashuri” do të vijojë të jetë në skenën e Teatrit “Migjeni” deri më 27 shtator. Premiera e nisi rrugëtimin mes humorit, emocioneve dhe duartrokitjeve, duke dëshmuar se në Shkodër dashuria për humorin vazhdon të jetë po aq e fortë sa gjithmonë. A.K./TemA



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Çelet te Vila 31 ekspozita kushtuar grave të Ballkanit](#)

09:17 Kulturë

[Koka e humbur e Titos: ikonoklazëm politik apo betejë për narrativën post-socialiste](#)

21:07 Kulturë / 1 koment

Të rinjtë dhe fëmijët, pjesë e pandashme e TIFF

17:49 Kulturë

Blendi Gonxhe: Në Butrint po punohet çdo ditë për të ruajtur trashëgiminë

16:50 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.